


REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.423/2022

Datë: 3 nëntor 2022

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 7, paragrafi 1, pika 1.14, të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj Lindita Jakupi, gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, sipas raportit të panelit hetimor Nr.AD/KGJK/14/2022/GJS-GJS-2022-011, të datës 12.10.2022, në pajtim me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, nenin 19 dhe 20 të Rregullores 05/2019, për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në seancën dëgjimore të mbajtur me 3 nëntor 2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

Lindita Jakupi, gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 2, nën paragrafi 2.9, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës (më tutje Këshilli), me datë 12 korrik 2022 ka pranuar kërkesën për fillimin e hetimit disiplinor nga Autoriteti Kompetente me pretendim së Lindita Jakupi, gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5 paragrafi 2, nën paragrafi 2.9 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent ka kërkuar nga Këshilli, si organ kompetent, të fillojë hetimin disiplinor dhe ka propozuar që ndaj të njëjtës, në rast se vërtetohet se ekziston shkelja disiplinore, t'i shqiptohet njëri nga sanksionet disiplinore adekuate të parapara sipas nenit 7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Kërkesës për fillimin e hetimeve, autoriteti kompetent ia ka bashkangjitur edhe provat e siguruar në atë fazë të procedurës.

Këshilli me vendimin KGJK.nr.332/2022, të datës 15.07.2022, ka themeluar panelin hetimor për rastin disiplinor Nr.AD/KGJK/14/2022/GJS-GJS-2022-011. Paneli hetimor me datë 12.10.2022, i'a ka paraqitur Këshillit raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduar.

Këshilli me 3 nëntor 2022, ka mbajtur seancë dëgjimore, ku morën pjesë Kryesuesi i panelit hetimor gjyqtari Besnik Feka dhe avokati Besnik Berisha si përfaqësues i subjekti të hetimit disiplinor.

Kryesuesi i panelit hetimor në seancën dëgjimore në Këshill deklaroi se bazuar në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, ka caktuar dhe mbajtur seancë dëgjimore me subjektin e hetimit disiplinor përmes platformës zoom, për shkak që subjekti i hetimit gjyqtarja Lindita Jakupi ka qenë jashtë vendit, por prezent të paneli hetimor ka qenë përfaqësuesi i subjekti avokati Besnik Berisha.

Më tutje, kryesuesi i panelit ka deklaruar se marrë parasysh fakte dhe provat me të cilat është filluar procedura hetimore, siç janë e-mali i pranuar nga Policia e Kosovës, me të cilin njoftohet se Njësia për Zbatimin e Urdhëresave, pas pranimit të urdhëresës nga Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda, me numër PP.I.nr.22K/22, me datë 14.06.2022, rreth orës 08:15 min., në mëngjes kanë shkuar në adresë të pandehurit K.J, i cili gjendej në arrest shtëpiak, me ç'rast janë njoftuar nga familjarët se i njëjti veç është nisur për në Prokurorinë Themelore Prishtinë, i shoqëruar nga motra e tij, Lindita Jakupi, në këtë rast subjekti i hetimit.

Autoriteti Kompetent kishte pretenduar se subjekti i hetimit ka konsumuar shkelje disiplinore pasi që ka shoqëruar vëllaun e saj, i cili akuzohet për vepër penale "Keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar", me çka ka ndikuar apo ka mundur të ndikoj në vendimin e gjyqtarit të Departamentit të Krimeve të Rënda në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe të prokurorit të rastit, lidhur me masën e arrestit shtëpiak, e cila ishte shqiptuar vëllaut të saj – të pandehurit.

Kryesuesi i panelit hetimor, në seancën dëgjimore përveç tjerash ka theksuar se nga provat të cilat janë administruar në seancën dëgjimore te paneli hetimor nuk është vërtetuar fakti se subjekti i hetimit, gjyqtarja Lindita Jakupi, e ka shoqëruar vëllaun e saj, i cili ndodhet nën masën e arrestit shtëpiak nga shtëpia e vëllaut të saj për në Prokurorinë Themelore Prishtinë, këtë fakt nuk e ka vërtetuar me prova as parashtruesi i ankesës disiplinore.

Avokati Besnik Berisha si përfaqësues i subjektit të hetimit gjyqtares Lindita Jakupi në seancën dëgjimore në Këshill deklaroi se ky rast disiplinor ka qenë një rast i cili është dashur që të trajtohet me qëllim që të mos baltoset gjykata. Raportit të panelit hetimor i janë bashkangjitur edhe provat e noterizuara të motrës se gjyqtares Lindita Jakupi, e cila ka deklaruar se ditën kontestuese ka marrë ditë pushimi dhe e ka shoqëruar vëllain e saj K.J nga Ferizaj në Prokurorinë Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, fotografi dhe raporti i analizave të gjyqtares Lindita Jakupi që e njëjta në ditën e njëjtë dhe në orë të njëjtë, kur ishte intervistuar nga Prokurori vëllai i saj, i akuzuari K.J, ka qenë për analiza në laboratorin "Olive" në Prishtinë. Sipas deklaramit të avokatit Berisha me këto prova është vërtetuar që gjyqtarja Lindita Jakupi nuk ka ndikuar në çështjen që është zhvilluar pranë Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti për Krime të Rënda dhe as në çështjen që ka qenë duke u zhvilluar pranë gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe as nuk janë shkelur urdhrat e ligjshme që ishin subjekt i masave të sigurisë së pranisë së vëllait të saj.

Për të vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore, Këshilli i administroj këto prova: Raportin mbi faktet dhe provat e mbledhura; kërkesën GJS-2022-011 për fillimin e hetimit disiplinor të paraqitur nga Autoriteti Kompetent me datë 12.07.2022 dhe bashkangjitur kërkesës është edhe njoftimi i

gjqtarit Alban Ajvazi, përmes emaili drejtuar Kryetarit të Gjykatës Supreme; Njoftimi i rreshteres se Stacionit të Policisë në Ferizaj Deklarata e subjektit te hetimit Gjyqtare Lindita Jakupi; Procesverbali i panelit hetimor për seancën dëgjimore te mbajtur me datë 23 gusht 2022, Procesverbalin e marrjes në pyetje të të Pandehurit K.J të datë 14.06.2022, Autorizimin e Av.Besnik Berisha të dhënë nga gjyqtarja Lindita Jakupi; Raportin mjekësor të dhënë nga Qendra e mjekësisë familja për gjyqtaren Lindita Jakupi të datës 27.05.2022; Raportin e ndërprerjes se Pushimit mjekësor të datës 17-27.05.2022; deklaratat e evidentuar si prova nr.1, shitës i marketit “Mini market” i cili gjendet në lagjen , Tregtia Rr.” , Raportin për analiza mjekësore të lëshuar nga laboratorit “Olive “, datë 14.06.2022, me ora 07:11 min; Deklaratën e motrës se subjektit të hetimit , Prova nr.4; vendimin e Këshillit KGJK.nr.345/2022, të datës 28 korrik 2022, me te cilin gjyqtare Lindita Jakupi i është lejuar pushimi pa pagesë për vazhdimin e studimeve të Doktoratës në Eëake Forest Universitz – North Carolina- SHBA, për periudhën kohore 30 gusht 2022 deri me 1 qershor 2023; Njoftimin për hapje të hetimit disiplinor, të datës 29.27.2022; E-maili i kryesuesit të Panelit gjyqtarit Besnik Feka dërguar Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë Kujtim Munishi; Transkriptin e panelit hetimor për seancën e mbajtur përmes zoom-it, me datë 26 shtator 2022; Njoftimin e Premtim Asllani qe e konfirmon se Qamile Jakupi është një ndër farmacistet përgjegjëse të laboratorit Olive; Përgjigjen e avokatit Besnik Berisha lidhur me hetimin e hapur disiplinor ndaj gjyqtare Lindita Jakupi për panelin hetimor; etj.

Nga provat e administruara në seancën dëgjimore në Këshill nuk është vërtetuar se subjekti i hetimit, gjyqtarja Lindita Jakupi, me datë 15 qershor 2022, e ka shoqëruar vëllaun e saj nga shtëpia e të njëjtit për në Prokurorinë Themelore Prishtinë.Me këtë rast Këshilli ka vlerësuar se pretendimet e ankuesit dhe të Autoritetit Kompetent lidhur me shkeljen disiplinore të pretenduar për subjektin e hetimit, nuk janë provuar, andaj, në mungesë të fakteve të provuara mbi bazën e të cilave do të mund të kualifikohet shkelja e pretenduar është gjetur se subjekti i hetimit nuk është përgjegjës, për shkeljen e pretenduara nga neni 5, paragrafi 2, pika 2.9, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KGJK.nr.423/2022, datë: 03 nëntor 2022

Albert ZOGAJ
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese drejtpërdrejtë në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda 15 ditëve nga pranimi i vendimit.

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Enver Peci, Kryetar në Gjykatën Supreme të Kosovës;
- Lindita Jakupi, Gjyqtare në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme;